



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

ADRESA: L. '5 MAJI', PALL. 34/1, PRANE ISH- GJYKATES, SHKA.1, KAT.2, ELBASAN CEL.0695105151



PERMBARUES GJYQESOR  
HALIT D. CANI

Elbasan, më 12.01.2023

Nr.04- 20 Gj Regjist

**U R D H E R**  
**VENDOSJE SEKUESTRO KONSERVATIVE**

**Drejtuar: Qëndres Kombetare e Biznesit**

**Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë.**

**Për Dijeni: 1-Shoqeria "Muka Konfeksion" sh.p.k. me NIPT L92423026G**

**Adresa: Rruga 'Mine Peza', Pallati 256/2, Tirane.**

**2- Shoqeria "Muka 1741" sh.p.k. me NIPT L93623203L**

**Adresa: Rruga 'Metalurgji', Godina nr.145, Elbasan.**

**3-Shoqeria 'DIEL' sh.p.k,**

**Adresa: Fshati Shirgjan, fshati Kryezjarr, zyrat e shoqerise ne rrugen Elbasan - Cerrik km2.**

Në Elbasan, sot më datë 12.01.2023, Unë Halit CANI përmbarues gjyqësor privat, me numër liçense 28, & (NIPT) L03411202U, me seli në Elbasan, pasi shqyrtova materialet e dosjes përmbarimore nr.04 – 20 Gj. datë 07.08.2020, që u përket palëve:

- **Subjekti Kreditor: Shoqëria "DIEL", sh.p.k.**
- **Subjekti Debitor solidare : 1-Shoqeria "Muka Konfeksion" sh.p.k.**  
· **2- Shoqeria "Muka 1741" sh.p.k.**
- **Objekti: Kthim Detyrimi (Fatura Tatimore Shitje)**

**K O N S T A T O V A:**

Se më datë 07.08.2020, është depozituar në zyrën përmbarimore të përmbaruesit gjyqësor privat z. Halit D. Cani, Elbasan, kërkesa e subjektit kreditor Shoqëria "DIEL", sh.p.k, për vënien në ekzekutim të urdhërit të ekzekutimit Nr.169, datë 12.03.2020, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan, për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, *per faturat tatimore te shitjes se sherbimit,*

1- Nr.Fature 112 nr.serie 38350668, date 31.07.2016, 2- Nr.Fature 130 nr.serie 38350686, date 31.08.2016, 3-Nr.Fature 136 nr.serie 38350692, date 30.09.2016, të lëshuara nga Shoq. "Diel", sh.p.k.

Në kushtet kur kane kaluar afatet e parashikuara nga neni 517 K. Pr. Civile, eshte vendosur fillimi i ekzekutimit te detyrueshem te titullit ekzekutiv (519 i ketij kodi), duhet te kryhet bllokimi mbi aksionet, kuotat e ortakeve asetet, etj, në emër të subjektit debitor subjektit debitor solidare: Shoqeria "Muka Konfeksion" sh.p.k.me NIPT L92423026G dhe Shoqeria "Muka 1741" sh.p.k. me NIPT L93623203L, deri në një urdhër të dytë nga kjo zyre permbarimore.

Sa sipër në baze të zbatimit të nenëve 527, 560, 563 e në vijues të K. Pr. Civile, dhe të ligjit 26/2019, neni 36, germa "e", dhe 53, pika 1,2.

### URDHEROJME:

- Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi aksionet, kuotat e ortakeve, asetet, etj që zotëron subjektin debitor solidare: Shoqeria "Muka Konfeksion" sh.p.k.me NIPT L92423026G dhe Shoqeria "Muka 1741" sh.p.k. me NIPT L93623203L

- Për veprimet apo mosveprimet tuaja na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

- Personat që behen pengesë, do të përgjigjen në baze të nenit 606/2, të K. Pr. Civile, e nenit 320, Kodit penal.

- Bashkangjitur një kopje të urdhërit të ekzekutimit Nr.169, datë 12.03.2020, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe titullin ekzekutiv Faturë Tatimore Shitje së shërbimit, 1- Nr.Fature 112 nr.serie 38350668, date 31.07.2016, 2- Nr.Fature 130 nr.serie 38350686, date 31.08.2016, 3-Nr.Fature 136 nr.serie 38350692, date 30.09.2016, të lëshuara nga Shoq. "Diel", sh.p.k.

PERMBARUES GJYQËSOR

Halit CANI



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE  
PRANE RRETHIT GJYQSOR ELBASAN

NR.REGJ.THEMELTAR 169  
NR.VENDIMIT 169

DATA E REGJISTRIMIT 02.03.2020  
DATA E VENDIMIT 13.01.2022

V E N D I M

“ MBI LESHIMIN E URDHERIT TE EKZEKUTIMIT “

Gjykata e Shkalles se pare prane Rrethit Gjyqsor Elbasan e perbere prej :

KRYETARE SEANCE ZAMIRA VYSHKA

Asistuar prej sekretares Jorna Santo,ne Elbasan, sot ne daten 12.03.2020, shqyrtoi ne dhome keshillimi ceshtjen adm.civile qe i perket kerkeses se :

**PALE KERKUESE: SHOQERIA “DIEL”,sh.p.k**, me NIPT J62903297I, me administrator Tefik Kaziu, me seli ne fshatin Shirgjan,fshati Kryezjarr zyrat e shoqerise ne rrugen Elbasan Cerrik km2.

**OBJEKTI** :Leshim urdher ekzekutimi per titujt ekzekutiv faturat tatimore te shitjes: nr.112 dt.31.07.2016 ne shumen 3.831.540 leke, nr.130 dt.31.08.2016 ne shumen 1.387.944 leke, nr.136 dt.30.09.2016 ne shumen 1.770.888 leke.Kerkimin e kamatave ligjore ne baze te nenit 5 te ligjit 48/2014 per”Pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare”.

**BAZA LIGJORE** :Neni 510/e,511/c/d te K.Pr.Civile dhe ligji 48/2014,.ligji 9920/2008”Per procedurat tatimore”ligji 92/2014”Per T.V.SH.”nenet 79,419,420,445,481,485,659,690,705 te K.Civil dhe nenet 31,32,36, 253, 255, 260,510,511 te K.Pr.Civile.

Ne perfundim te hetimit gjyqsor dhe pas administrimit te provave te nevojshme,Gjykata si shqyrtoi ceshtjen ne teresi,ne dhome keshillimi, konform nenit 511/3, te ndryshuar te K.Pr.Civile :

V E R E N

**Subjekti kerkues Shoqeria Tregtare “DIEL.”sh.p.k.** eshte e organizuar ne formen e personit juridik me pergjegjsi te kufizuar,dhe e ushtron aktivitetin e saj tregtar me seli ne kete adrese: ne fshatin Shirgjan,fshati Kryezjarr zyrat e shoqerise ne rrugen Elbasan Cerrik km2,dhe ka per administrator shtetasin Tefik Kaziu.Kjo shoqeri ushtron aktivitet tregtar ne fushen e ndertimit dhe te veprave ndertimore te te gjithë llojeve etj.Kete informacion gjykata e mori nga ekstrakti i regjistrimit tregtar te pales kerkuese

dt.28.02.2020.

**Nga ana tjetër shogeria tregtare "Muka" sh.p.k.** është e organizuar, edhe ajo në formën e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me seli në qytetin e Elbasanit dhe me adresë të ushtrimit të aktivitetit në adresën: rruga Metalurgji, godina nr.145 z.k.3965 pasuria nr.424, Elbasan. me nr.Nipti K22008002D.

Nepërmjet kërkesës objekt gjykimi, pala kerkuese ka pretenduar se ka kryer shërbime për palën debitore dhe nuk ka marrë kundravlëftën e këtij shërbimi sipas faturave tatimore të shitjes nr.112 dt.31.07.2016 në shumën 3.831.540 leke, nr.130 dt.31.08.2016 në shumën 1.387.944 leke, nr.136 dt.30.09.2016 në shumën 1.770.888 leke. Po ashtu pala kerkuese kërkon edhe kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare.

Në provim të mardhënjes së saj tregtare me palën debitore, dhe në favor tëleshimit të urdherit të ekzekutimit, për titujt ekzekutiv të pretenduar prej saj, pala kerkuese i ka paraqitur gjykates faturen tatimore të shitjes të njehsuar me origjinalin, ekstraktet e Q.K.B. për palën kerkuese dhe palën debitore, preventivat e punimeve etj.

**Analizuar kërkesa e pales kerkuese, nga këndvështrimi i neneve 510/e e 511 i ndryshuar i K.Pr.Civile** rezulton se ajo është e mbështetur në ligj, pasi titulli ekzekutiv kërkohej të vihet në ekzekutim nga kreditori që në rastin konkret është pala kerkuese, prandaj në këtë drejtim kjo e fundit ka mbi vete legjitimitetin aktiv në ngritjen e kesaj kerkese.

Pala kerkuese e ka mbështetur kerkimin e saj në nenin 510 të K.Pr.Civile si dhe në ligjin 48/2014 "Për pagesat e vonuara, në detyrimet kontraktore e tregtare", nëni 16 i tij.

Nga analiza që gjykata i bëri akteve të dosjes, përputhur përmbajtja e tyre me ligjin dhe me faktin, e cila gjykaten në konkluzionin se kërkesa e pales kerkuese duhet pranuar si e bazuar në prova e ligj mbi bazën e këtij arsytimi :

**Analiza ligjore e cështjes :**

Sa i takon themelitet të cështjes, në kuptim të Nenit 510/e të K.Pr.Civile : **"Ekzekutimi i detyrueshem mund të behet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv". Jane tituj ekzekutive: e) Aktet e tjera që sipas ligjeve të vecanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbartimit për ekzekutimin e tyre.**

Nisur nga dispozita e sipërme rezultojnë se rasti në gjykim, i përmbush kriteret e ligjit që akte të tilla sikunder janë faturat tatimore të shitjes nr.112 dt.31.07.2016 në shumën 3.831.540 leke, nr.130 dt.31.08.2016 në shumën 1.387.944 leke, nr.136 dt.30.09.2016 në shumën 1.770.888 leke, të konsiderohen si tituj ekzekutiv e të nënshtrihen fazës së ekzekutimit. Në këtë vendimarrje gjykata erdhi, pasi u konsultua, edhe me ligjin specifik nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara, në detyrimet kontraktore e tregtare" e konkretisht :

**Në bazë të nenit 1 të ligjit nr. 48/2014 "Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatave ligjore për pagesat e vonuara, në rastet e furnizimit me mallra apo**

shërbime nga ana e ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm, duke nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve tregtare dhe, në veçanti, të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

**Ne baze të nenit 16 të ligjit**: "Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur: a-kreditore ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin." **Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile."**

Ne interpretim të dispozitave të sipërme, rezulton se që të zbatohet ky ligj, në mardhenjet tregtare midis subjekteve, duhet të plotësohen njëherazi në mënyrë kumulative dy kushtet e sipërme: **a-Levrimi i mallrave nga ana e pales kreditore, që në fakt, sipas pales kerkuese, dhe e provuar me faturen perkatëse, tatimore të shitjes ka ndodhur, kjo pale ka ofruar shërbimin e saj për palen debitore duke e furnizuar me produktet e saj. b-Debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.**

Duke analizuar percaktimet e Ligjit 48/2014, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, percaktimi i nenit 16 në raport me kërkesën objekt gjykimi, mund të aplikohet, pasi nga ana e pales kerkuese janë përmbushur në mënyrë kumulative të dy kushtet e percaktuara në këtë nen, të cilat i japin çështjes së titullit ekzekutiv faturreve tatimore të shitjes, pasi nga ana e pales kerkuese është bërë levrimi i shërbimit teksa është pala debitore ajo që nuk ka paguar kundër vlefshëm të preventivave të punimeve të kryera në favor të saj, sipas fatures perkatëse, e për më tepër nuk rezulton që ta ketë kundërshtuar këtë detyrim.

Titulli ekzekutiv është akti përfundimtar që përmban njohjen e detyrimit të plotë, të saktë, të percaktuar të një personi apo subjekti kundrejt një tjetri sipas parashikimeve të ligjit. **Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin Unifikues Nr. 980, datë 29 Shtator 2000, janë shprehur se:**

**"Që një akt i nxjerrë nga një organ kompetent shtetëror, apo i përgatitur e i vertetuar nga një nepunës publik, në kushtet e parashikuara në mënyrë eksplicite në ligj, të jetë titull ekzekutiv, duhet të përmbajë një detyrim të njohur e të percaktuar saktë, të kerkueshëm, që nuk lidhet me plotësimin e afateve të caktuara, dhe, mbi të gjitha, të pakushtezuar nga rrethanat e tjera apo nga detyrime të tjera të ndërsjella".** Cka do të thote se e drejta që kerkohet të zbatohet dhe që përmendet në titullin ekzekutiv, duhet të jetë e qartë dhe e saktë, e kerkueshme dhe e ekzekutueshme."

Nisur nga kjo panoramë mardhenjesh tregtare midis paleve, dhe nga ky interpretim i ligjit specifik gjykata krijoi, bindjen se pala debitore, ndonëse e ka marrë mallin sipas fatures perkatëse, nuk e ka shlyer atë, provuar kjo sjellje e saj, me të gjitha korespondencën që paraqiti pala kreditore me këtë rast. Në këto rrethanat gjykata e gjen të provuar kerkimin e pales kreditore për leshimin e urdherit të ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes së shërbimit nr.112 dt.31.07.2016 në shumën 3.831.540 leke, nr.130 dt.31.08.2016 në shumën 1.387.944 leke, nr.136 dt.30.09.2016 në shumën 1.770.888 leke.



Nisur nga sa sipër, por jo vetëm, interpretuar në përgjithësi fatura tatimore e shitjes, objekt shqyrtimi, në raport me faktet konkrete të çështjes, gjykata krijon bindjen se juridikisht plotësohen cilësitë dhe karakteristikat formale, si dhe ato substanciale të një titulli ekzekutiv, për faturën tatimore, nga ai që parashikon gërma "e" të nenit 510 i Kodit të Procedurës Civile sipas të cilit në mënyrë eksplicite shprehet: "Aktet e tjera që sipas ligjeve të vecanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbartimit për ekzekutimin e tyre". Pra kemi të bëjmë me fatura tatimore shitje, të cilat ligji specifik, 48/2014 i konsideron si titull ekzekutiv, për të cilën vertetë detyrimi është bërë i kërkueshëm, dhe është konfirmuar si i tillë nga pala e interesuar kreditore.

Krijimi i marrëdhënies juridike të ekzekutimit të detyrueshëm kërkon të ekzistojnë njëherazi disa elementë juridike dhe faktike në mënyrë që të kënaqen interesat e ligjit, e të arrihet qellimi i pales kreditore.

Ligji parashikon se titulli ekzekutiv që të ekzistojë si i tillë, duhet të jetë i padyshimtë për nga të drejtat që i jep kreditorit dhe që ligji duhet t'a njohë cilësinë e "titullit ekzekutiv". Në këtë kuptim juridik, titulli ekzekutiv është akti përfundimtar që përmban njohjen e detyrimit të plotë, të saktë, të përcaktuar të një personi apo subjekti kundrejt një tjetri sipas parashikimeve të ligjit.

Praktika gjyqësore e ka të konsoliduar tashmë konceptin e titullit ekzekutiv, cilesite që ai duhet të gëzojë për të qene i tillë

1-Kështu një titull ekzekutiv, që përmban një detyrim në të holla, sikunder është dhe rasti konkret, fatura tatimore e shitjes, duhet të jetë veprim juridik i njëanshem në kuptimin e shpërndarjes së të drejtave midis palëve. Ai duhet të prodhojë vetëm të drejta për një palë dhe vetëm detyrime për palën tjetër, në kuptimin që nuk duhet të prodhojë detyrime të ndërsjellta apo të varet nga vërtetimi ose jo i rrethanave të caktuara, sikunder ndodh në rastin konkret, kur kemi një konfirmim të sakte të detyrimit.

2-Gjithashtu, detyrimet apo të drejtat që prodhon ky veprim juridik formal, në rastin konkret janë të thjeshta, të pakushtëzuara apo të pakondituara dhe krejt të pavarura nga njëra tjetra.

3-Detyrimi i pales debitore, në rastin konkret, është i përcaktuar saktë dhe qartë dhe është bërë i kërkueshëm,

Këto karakteristika janë krejtësisht në kuptimin dhe filozofinë juridike të institutit të titullit ekzekutiv, pasi ky i fundit është një e drejtë e padyshimtë e kreditorit potencialisht e aftë të realizohet me forcën shtrënguese të shtetit, pasi fuqia e tyre ekzekutive është e njëjtë me titullin më klasik e më përfaqësues ekzekutiv sikur është vendimi gjyqësor civil detyrimi i formës së prerë. Në këtë kuptim, këto tituj nuk mund t'i nënshtrohen një gjykimi themeli për t'u kontestuar, por si të gjithë titujt e tjerë ekzekutiv mund të goditen për fallsitet apo të kundërshtohen për pavlefshmëri sipas parashikimeve të nenit 609 të K.Pr.Civile.

Si përfundim, kërkesa e pales kërkuese, është e bazuar në ligj e si e tillë ajo përben shkak për leshimin e urdherit të ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes nr.112 dt.31.07.2016 në shumën 3.831.540 leke, nr.130 dt. 31.08.2016 në shumën 1.387.944 leke, nr.136 dt.30.09.2016 në shumën 1.770.888 leke.



**PER KETO ARSYE**

Gjykata ne baze te neneve 510/e,511, 512 te K.Pr .Civile

**VENDOSI**

Pranimin e kerkeses se pales kerkuese subjektit juridik shoqeria **"DIEL" sh.p.k.**

Leshimin e urdherit te ekzekutimit per faturat tatimore te shitjes se sherbimit nr.112 dt. 31.07.2016 ne shumen 3.831.540 leke, nr.130 dt.31.08.2016 ne shumen 1.387.944 leke, nr.136 dt. 30.09.2016 ne shumen 1.770.888 leke, nxjerre kundrejt pales debitore, subjektit tregtar shoqeria **"MUKA" sh.p.k.**, si edhe pagimin e kamatave ligjore te llogaritura sipas ligjit nr.48/2014 **"Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore dhe tregtare"**.


Shpenzimet gjyqesore kryer prej pales kerkuese.

Vendimi ti komunikohet pales kerkuese brenda 3 diteve nga shpallja e tij.

Vendimi eshte i formes se prere.

U shpall ne Elbasan, sot ne date 12.03.2020.

GJYKOTARE  
ZAMIRA VYSHKA




ESTABLISHED  
1862





# FATURE TATIMORE SHITJE

Nr. i Serisë **38350692**

Data: **30 09, 2016**

EMRI I SHITËSIT: **Diel Sh.P.K.**

Nr. i Faturës: **136**

ADRESA: **Elbasan**

TELEFONI:

NUMRI IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIP)

J 6 2 9 0 3 2 9 7 1

EMRI I BLERËSIT: **Muka Sh.P.K.**

ADRESA: **Tirane**

TELEFONI:

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIP)

K 2 2 0 0 5 0 0 2 0

EMRI I TRANSPORTUESIT:

ADRESA:

TARGA E MJETIT:

ORA E FURNIZIMIT:

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIP)

Nr	Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	Njësia e Matjes	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Vlefte pa TVSH	Vlefte e TVSH	Vlefte me TVSH
1	2	3	4	5	6=4x5	7=6x20%	8=6+7
	<b>Summe sipos situacionit bashkëngjitur</b>				<b>1475740</b>	<b>295148</b>	<b>1770888</b>
	<b>Rekorstrukcion magazinës së cilës kombinuar me kalurgji</b>						

**TOTALI**

**1475740 295148 1770888**

Nga të cilat: Furnizime të tatueshme

Furnizime të paratueshme

- a) faqe 1: Originali - Blerësi
- b) faqe 2: Transportuesi
- c) faqe 3: Shitësi

**BLERËSI**

(emër, mbiemër, nënshkrimi)

*Belona Muka*

**TRANSPORTUESI**

(emër, mbiemër, nënshkrimi)

**SHITËSI**

(emër, mbiemër, nënshkrimi, vulë)

*Refik Kona*

SHOIRP  
D. CA  
LITYH



Elbasan me 30/09/2016

Shoq. Nd. „DIEL“shpk

Adresa: Rruga Elbasan – Cerrik Km 2-te

Tel:

Cel:0694078940, 0682078940

Email: dielshpk@yahoo.com



**SUPERACIONE PUNIMEVE**

**Objekti: Rikonstruksion magazine ne ish kombinatin metalurgjik**


**Prosesi: Muka shpk**

**Statues: Diel shpk**

Nr	Pershkrimi Punimeve	Njesi	Sasia	Çmimi LEK	Shuma
1	Puntori ne dispozicion per prishje te ndryshme	dite	5.00	1,300	6,500
2	Funizim vendosje suvatimi	m2	1,806	500	903,000
3	Shtrese me helikopter	m2	925.00	170.0	157,250
4	F/v gomine ne shtrese	ml	1,075.00	50.0	53,750
5	vendosje zgarash per shtrese	m2	238.00	20.0	4,760
6	germin me krah	m3	10.00	500.0	5,000
7	Betonim muresh ashensori	m3	1.36	3,500.0	4,760
8	F/v shtres niveluese per pllaka	m2	290.00	550.0	159,500
9	F/v betonim tortuaresh	m3	13.94	13,000.0	181,220
10					
		Shuma		Lek	1,475,740
		Tvsh		20%	295,148
12		Shuma Totale		Lek	1,770,888

Per "DIEL,,sh.p.k  
Administratori  
TEFIK KAZIU

Per . "Muka shpk  
Administratori



Mbykqyersi i punimeve ( super vizor )  
NDRICIM HAMZA



1974  
C  
1974

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DËRRËS  
NOTER EVIS J. KOBURJA

DATE 24/02/2020  
NR REP 1077



### VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN

Sot, më datë 24/02/2020, para meje Noteres EVIS J. KOBURJA, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Lagja 5 Maj, Elbasan, u paraqit personalisht:

#### KËRKUES/IT:

TEFIK KAZIU, atësia Ali, shtetas Shqiptar, lindur në Arap i Poshtem Diber dhe banues në ELBASAN, me adresë ELBASAN, lindur më 10/02/1972, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me leternjoftimin me nr. personal H20203009K, i cili me kerkoj njesimin e dokumentit me originalin.

**FATURE TATIMORE SHITJE**, ne emer te DIEL sh.p.k, Nr.136, date 30.09.2016, bashkelidhur situacion punesimesh date 30.09.2016.

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER  
EVIS J. KOBURJA





Nr. i Serisë 38350658

# FATURË TATIMORE SHITESH

EMRI I SHITËSIT: DIEL SHITËSIT



ADRESA: Elbasan

TELEFONI: \_\_\_\_\_

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT) \_\_\_\_\_

EMRI I BLERËSIT: MURO

ADRESA: TIRANE

TELEFONI: \_\_\_\_\_

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT) \_\_\_\_\_

EMRI I TRANSPORTUESIT: \_\_\_\_\_

ADRESA: \_\_\_\_\_

TARGA E MJETIT: \_\_\_\_\_

ORA E FURNIZIMIT: \_\_\_\_\_

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT TË TATUESHËM (NIPT) \_\_\_\_\_

Nr	Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	Njësia e Matjes	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Vlefëta pa TVSH	Vlefëta e TVSH	Vlefëta me TVSH
1	2	3	4	5	6=4x5	7=6x20%	8=6+7
1	Punime sipas shërbimit bashkë me produktin "Rindërtim i tablerit në apartamentin shërbimet në shtet"	m <sup>2</sup>	312.95	638.580	231.300	46.260	277.560
TOTALI					192.95	638.580	231.300

Nga të cilat: Furnizime të tatueshme  
Furnizime të paratueshme

192.95	638.580	231.300

a) faqe 1: Originali - Blerësi  
b) faqe 2: Transportuesi  
c) faqe 3: Shitësi

**BLERËSI**  
(emër, mbiemër, nënshkrimi)  
Muro

**TRANSPORTUESI**  
(emër, mbiemër, nënshkrimi)

**SHITËSI**  
(emër, mbiemër, nënshkrimi, vullë)  
Diell Shitësi

TVSH  
HSAL  
TVSH  
HSAL  
TVSH  
HSAL  
TVSH  
HSAL  
TVSH  
HSAL

TVSH  
HSAL  
TVSH  
HSAL  
TVSH  
HSAL  
TVSH  
HSAL  
TVSH  
HSAL





Shoq. Nd. „DIEL“shpk  
 Adresa: Rruga Elbasan – Cerrik Km 2-te  
 Tel:  
 Cel:0694078940, 0682078940  
 Email: dielshpk@yahoo.com

Elbasan me 31/7/2016


**SITUACION PUNIMESH**

Objekti: Rikonstruksion magazine ne ish kombinatin metalurgjik  
 Porositesi: Muka shpk  
 Zbatues: Diel shpk


Nr	Pershkrimi Punimeve	Njesi	Sasia	Cmimi LEK	Shuma
1	Funizim vendosje mur tulle I lehtesuar	m3	151	6,000	906,000
2	Puntori ne dispozicion per prishje dhe heqje zgarash	dite	39	1,300	50,700
3	Funizim vendosje hekuri per brezat	kg	3,300	100	330,000
4	Funizim vendosje beton mark 250 per breza dhe arkitrare	m3	30	13,000	390,000
5	Ore pune me matrapik dore , per prishje te ndryshme	ore	16	500	8,000
6	Puntori per lluster ne parvazet e dritareve	m2	55	150	8,250
7	Funizim vendosje suvatimi	m2	3,000	500	1,500,000
Shuma				Lek	3,192,950
Tvsh				20%	638,590
Shuma Totale				Lek	3,831,540

Per "DIEL,,sh.p.k  
 Administratori  
 TEFIK KAZIU

Per "Muka,,shpk  
 Administratori  
 BELMA MUKA



Mbykqyersi I punimeve ( supervizori )  
 NDRICIM HAMZA



3/300

ulë)

0550

SHARP  
& CO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTER EVIS J. KOBURJA

DATE 24/02/2020  
NR REP 1075



PULLË TËRIFË

Y2020010550032097765

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGJINALIN

Sot, më datë 24/02/2020, para meje Noteres EVIS J. KOBURJA, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Lagja 5 Maj, Elbasan, u paraqit personalisht:

**KËRKUES/IT:**

TEFIK KAZIU, atësia Ali, amësia Fusha MemesiPale, shtetas Shqiptar, lindur në Arap i Poshtem Diber dhe banues në ELBASAN, me adresë ELBASAN, lindur më 10/02/1972, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me leternjoftimin me nr. personal H20203009K, i cili me kerkoj njesimin e dokumentit me origjinalin.

**FATURE TATIMORE SHITJE**, ne emer te DIEL sh.p.k, Nr.112, date 31.07.2016, bashkelidhur situacion punesimesh date 31.07.2016.

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit original me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezulton se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER  
EVIS J. KOBURJA

1901  
D. C. 100





10/10/2020

Elbasan me 31/8/2016

Shoq. Nd. „DIEL“shpk

Adresa: Rruga Elbasan – Cerrik Km 2-te

Tel:

Cel:0694078940, 0682078940

Email: dielshpk@yahoo.com



**SITUACION PUNIMESH NR 2**

Objekti: Rikonstruksion magazine ne ish kombinatin metalurgjik

Porositesi: Muka shpk

Zbatues: Diel shpk

Nr	Pershkrimi Punimeve	Njesi	Sasia	Çmimi LEK	Shuma
1	Funizim vendosje mur tulle I lehtesuar	m3	3.76	6,000	22,560
2	Puntori dhe llac per mur tulle 025	m3	4.00	2,500	10,000
3	Puntori ne dispozicion per prishje dhe heqje zgarash	dite	15.00	1,300	19,500
4	Funizim vendosje beton mark 250 per breza dhe arkitrare	m3	8.87	13,000	115,310
5	Ore pune me kamion me vinc per heqje ne dyerve	ore	3	3,000	9,000
6	Puntori per lluster ne parvazet e dritareve	m2	28	150	4,200
7	Funizim vendosje suvatimi	m2	1,570	500	785,000
8	Funizim vendosje finoje ne kollona betoni	m2	575.00	250.0	143,750
9	Funizim vendosje gomine ne katin e dyte per fugat	m1	246.00	50.0	12,300
10	puntori per kanale te tubacioneve te elektrikut +prekje me sharre	total	1.00	35,000.0	35,000
		<b>Shuma</b>		<b>Lek</b>	<b>1,156,620</b>
			<b>Tvsh</b>	<b>20%</b>	<b>231,324</b>
		<b>Shuma Totale</b>		<b>Lek</b>	<b>1,387,944</b>

Per "DIEL,,sh.p.k

Administratori


TEFIK KAZHU



Per . "Muka ,,shpk

Administratori

BELMA MUKA



Mbykqyersi I punimeve (supervizori)

NDRICIM HAMZA

10/10  
KUALA  
HALIM  
BERMUDA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTERI EVIS J. KOBURJA**

**DATE 24/02/2020  
NR REP 1076**



V2020010550032845763



**VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN**

Sot, më datë 24/02/2020, para meje Noteres EVIS J. KOBURJA, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Lagja 5 Maj, Elbasan , u paraqit personalisht:

**KËRKUES/IT:**

TEFIK KAZIU, atësia Ali, amësia Fusha MemesiPale, shtetas Shqiptar, lindur në Arap i Poshtem Diber dhe banues në ELBASAN, me adresë ELBASAN, lindur më 10/02/1972, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me leternjoftimin me nr. personal H20203009K , i cili me kerkoj njesimin e dokumentit me origjinalin.

**FATURE TATIMORE SHITJE**, ne emer te DIEL sh.p.k, Nr.130, date 31.08.2016, bashkelidhur situacion punesimesh date 31.08.2016.

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezulton se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER  
EVIS J. KOBURJA**

